Lezhë, më 30.01.2024

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 30.01.2024, në orën 12:00, në sallën e bibliotekës "At' Gjergj Fishta" Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të këshillit të Bashkisë Lezhë, për muajin Janar 2024.

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës të njoftuar.

- Ndue Luli: Kush është dakord me rendin e ditës?

Miratohet me 23 vota PRO

KUNDRA nuk ka. ABSTENIM nuk ka.

- kërkoi fjalën z. Artan Ndreu, i cili foli rreth një certifikate mirënjohjeje të dhënë në mbledhjen e kaluar
- Iu përgjigj shkurtimisht kryetari z. Ndue Luli.
- Ndue Luli: Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës që është Raport nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor 2024 dhe tre vitet e ardhshme buxhetore 2025-2027.

Fjala për ju z. drejtor.

- Dritan Boçi (drejtor DTTV) – Sipas kalendarit për buxhetin afatmesëm, kemi parapitur një raport për parashikimin e të ardhurave për vitin fiskal 2024 dhe tre vitet e ardhshme. Në raport jepen vlerësimet dhe parashikimet sipas burimeve të veta, të kategorizuara në takse vendore, tarifa vendore, taksa të ndara dhe të ardhura të tjera. Dy fjalë për metodologjinë e ndërtimit të raportit të vlerësimit: Ne i kemi

projektuar të ardhurat mbi bazën e kapaciteteve fiskale që ka Bashkia Lezhë në numrin e bizneseve, biznes i vogël, biznes i madh, që kanë pronarët e godinave për përdorime ekonomike, si dhe në numrin e familjeve duke përjashtuar ato që janë të parashikuara në ligj dhe në paketën fiskale të miratuar, për lehtësira fiskale. Kemi marrë në konsideratë edhe implementimin e sistemit të ri që tashmë është realitet në vitin 2023, që do na sjellë eficiencë sa më të mirë në mbledhjen e të ardhurave dhe me punën që ka filluar që nga 1 janari në terren, poftë nga struktura e DTTV por dhe nga njësitë vendore dhe drejtori të tjera dhe jashtë bashkisë, që po bashkërendojnë punën për mbledhjen e të ardhurave.

- Flutura Gjoni: Vlerat janë në lekë apo në mijë lekë?
- Dritan Boçi: Janë në mijë lekë.
- Alfrida Marku: Së pari uroj një vit të mbarë. U njohëm me raportin. Jemi në janar por këtu do jemi edhe në dhjetor. Unë jam e bindur që do përsëritet e njëjta situatë si në fund të vitit 2023 kur bashkia kishte vetëm 48% të ardhurat të realizuara. Unë i jam referuar në plan krahasues 10 mujorit të vitit 2023 dhe nqs marrim zërin e veçantë për taksat vendore, rezulton vetëm 48% të realizuara. Planin në vitin 2023, që e kishit 493 mln lekë, ndërkohë faktin 238 mln lekë.

Ndërkohë planin për vitin 2024 e keni 640 mln lekë, për 2025 – 653 mln lekë. Nëse i krahasojmë me vitin që sapo mbyllëm, i bie për vitin 2024 – 63% më shumë) keni parashikuar sesa faktin e realizuar në vitin 2023 dhe për 2025-n keni parashikuar 64% më shumë të ardhura se sa fakti i realizuar në vitin 2023. Ndërkohë nga 2025 në 2027 keni rritje me 2% të realizimit të të ardhurave. Të njëjtin raport e kam parë edhe te tarifat vendore. Çfarë ka ndryshuar? Ka, ka një hendek midis planit dhe faktit. Sepse kjo na çon në një planifikim optimist fiktiv, që sjell pasoja te realizimi i buxhetit. Prandaj thirrja ime është që të mos ngulmoni në fiktivitet, sepse jo vetëm konfirmoni paaftësinë dhe pamundësinë e bashkisë për të realizuar të ardhurat, por sillni pasoja te qytetarët sepse mosrealizimi i të ardhurave sjell mosrealizim të buxhetit (projekteve)

- Ndue Luli: Të lutem drejtor mbaje shënim. Fjalën e ka zv/kryetari i këshillit

- Agostin Marku i Folemindërit. Së pari, unë dua të them që është gjë pozitive që kjo mbledhje e parë për vitin, fillon dhe pika e parë e rendit të ditës është një çështje e cila është planifikuar në planin tematik të këshillit për vitin 2024, çka tregon se jemi në rrugë të mbarë, duke filluar të thirresë në raportim të gjitha institucionet vendore dhe

ato rajonale që shërbejnë në Lezhë, për të rritur rolin dhe autoritetin e këshillit për sa i përket kërkesave që këshilli, por edhe komunitetit që ne përfaqësojmë, ka për këto institucione. Gjithçka që ne diskutojmë sot, është e miratuar nga ne në dhjetor 2023. Pozitive është që ajo që është paraqitur në këtë material, jep premisa për t'i ndjekur më mirë detyrat që janë për këtë drejtori, për të realizuar ato të dhëna që janë planifikuar në buxhetin e Bashkisë Lezhë, të cilat duhet t'i shërbejnë në konkretizimin e të gjitha atyre objektivave dhe shpenzimeve të planifikuara që në shërbim të qytetarëve dhe zhvillimit të Lezhës. Është gjë pozitive sepse gjithçka është e detajuar dhe kjo bën të mundur që detyrat të ndiqen në vazhdimësi nga drejtoria përkatëse, por edhe aty ku mund të lindin probleme, të gjendet mundësia për t'i riparuar. dhe për të konkretizuar atë plan buxheti që kemi, edhe nëpërmjet atyre mekanizmave ambicioze që ka paraqitur drejtoria kur kemi miratuar Paketën Fiskale.

- Arton Ndreu: z. drejtor, kisha një pyetje në lidhje me taksat. A është e mundur që në çdo njësi të caktohet një, po e quaj taksambledhës, që t'i informojë banorët?
- Ndue Luli: Vazhdojmë me pyetjet.
- Donika Haxhia: Përshëndetje të gjithëve.

këtu flitet që të ardhurat do të rriten duke rritur bazën e taksueshme me mbi 13% për vitin 2024. Nisur dhe nga ajo që keni shkruar, do bëni një fushatë sensibilizuese. Kjo tregon që deri në këtë moment, jo të gjithë kanë paguar taksa, pra nuk kanë qenë të regjistruar. E dyta, në lidhje me tarifat, duke pasur si burim biblioteka, muze, sport, konvikt, kopshte, çerdhe, qendra kulturore etj. Për shkak se numri i turistëve është rritur duhet të rritni dhe shifrën te tarifat e muzeut. Për kopshtet thoti 5%. Si do të realizohet kjo, kur ndërkohë janë mbyllur kopshtet e fshatit. Më parë këta nuk janë tarifuar dhe do rritet vetëm për qytetin? Tjetër – për shërbimet – tarifa për pastrimin – në të gjithë ato zona ku pastrimi është i pamundur në periudhën mesvjeshte, fundpranvere kur janë dëborë nën ujë dhe nuk mund të pastrohen, si do tarifohen qytetarët, kur nuk realizohet ai shërbim.

– Ndue Luli: Pyetje tjetër? Nuk ka.

Atëherë vazhdojmë me dhënien e përgjigjeve.

– Dritan Boçi: Sa i përket planifikimit të të ardhurave – ju thashë që metodologjia ka qenë mbi bazën e thjeshtë siç e kanë edhe bashkitë e tjera në nivel kombëtar mbi bazën e bizneseve dhe numrit të familjeve. Shifra që kemi parashikuar 640500 mijë lekë përfshin dhe taksën e infrastrukturës,

dhe taksën e pasurisë, që është kyçesore në punën e përditshme të DTTV. Synimi jonë është kapaciteti fiskal dhe të kapet objektivi. Është e vërtetë që është rritje 63%, por nga vjen e gjithë kjo? Vjen sepse nga viti në vit rritet mbledhja e të ardhurave, konkretisht vitet 2022-2023 për taksat vendore. Faktikisht në vitin 2023 është implementimi i sistemit të taksave në Bashkinë e Lezhës. Me logjikë ekonomike, nëse kishim rritje me 40% në vitin paraardhës, pse mos të kemi 60% planifikimin, duke pretenduar që të punohet më mirë nga DTTV dhe njësitë bashkëpunuese dhe gjithë agjentët tatimorë të kontraktuar. Në Paketën Fiskale të miratuar për vitin 2024, Bashkia Lezhë vazhdon të mbajë nën pragun minimal të referencës ligjore, taksat. Ne kemi shtuar këtë vit si përjashtime dhe gratë kryefamiljare etj që janë të listuara. Këtë vit ka pasur ndryshim dhe taksa e infrastrukturës në strukturë të bujqësisë dhe blegtorisë që ka shkuar në pragun minimal të lejuar nga ligji. Taksa e tokës bujqësore zero kur mbillet me frutikulturë dhe vreshtari. Problemi që kemi ne është informimi karshi taksave dhe familjarët nuk është se kanë një pagesë të lartë. Masat që ka marrë bashkia kanë qenë rikonceptimi i Drejtorisë së Taksave duke shtuar dy punonjës që do merren vetëm me taksat e familjarëve që do operojnë shtëpi më shtëpi, njëkohësisht me procesin në njësitë administrative

Disa herë janë bërë njoftime nga faqja e borxhisë për çdo muaj që merr DTTV ndaj kategorive biznes dhe familjarë. Sa i përket pyetjes së zonjës, ne parashikojmë rritjen e bazës së taksueshme dhe sensibilitim gjithë mediatik, gjithë dhe në lidhje me përgjigjen për kolegun. Për sa i përket kategorisë biznes, nuk ka asnjë subjekt që ka ngelur i pafaturuar për vitin 2023. Që nuk paguajnë dhe vonojnë në pagesë, po, ka plot. Çdo ditë sistemi po u kalkulon kamatvonesa. Ne vazhdojmë me sektorin e borxhit me njoftime, me bllokim llogarish bankare dhe me radhë pastaj dhe bllokimet në hipotekë. Sa i përket familjarëve - është një punë që po e rindërtojmë prej fillimi. Jemi duke rikonceptuar gjithë bazën e të dhënave për pasurinë e familjarëve. Po bashkëpunojmë me AKSHI-n, me ASHK-në, me Ujësjellësin dhe të gjithë me radhë që të arrijmë të krijojmë një regjistër përfundimtar të familjarëve për mbledhjen e taksave.

- Donika Hoxhia: Atëherë rritje do jetë për familjarët? Sepse çdo vit po mbyllen bizneset

- Dritan Boçi: Nuk ka rritje taksash për familjarët. Taksat janë në nivelin më të ulët që e lejon ligji. Nuk nuk më rezulton që po mbyllen. Po të doni ju sjell dhe statistikat. Numri është me plus. Ka biznese që mbyllen. Ka biznese që ngrihen të reja dhe vazhdojnë. Tek biznesi kemi një problematikë që është deklarimi fiktiv i pasurisë. Duhet të

Mbështetur në llogaritjen, rreth 67 % e të gjitha të ardhurave vijnë nga kategoria biznes. Kapitulli (familjet) zënë një % shumë të vogël te tarifat vendore.

- Ndue Luli: Po z. Tushaj.
- Pjetër Tushaj: Përshëndetje. Duke qenë se kam biznes, unë desha një sqarim nga ju. Në Shëngjin ka shumë informalitet. Tani që ka dalë ligji për të gjitha shtëpitë që lëshohen me qera, meqë paguaj unë, të paguajnë edhe ata. Aty ka njerëz që punojnë në informalitet. Si do të veprohet nga ju? Kurse për pjesën tjetër nuk jam i pakënaqur.
- Ndue Luli: Faleminderit z. Tushaj. Po z. drejtor.
- Dritan Boçi: Për rastin konkret që bëhet fjalë kryesisht për struktura akomoduese është ndërmarrë së fundmi dhe është miratuar projektligji i ri i turizmit, ku parashikohet një regjistër statistikor për të gjitha strukturat e hotelerisë, se nuk është problem vetëm të vendosë por edhe të mbështetet me deklarimet që ata bëjnë dhe ne si bashki do kemi akses në të për të marrë informacionin e plotë për të gjithë klientët dhe netët e fjetjes, çka sjell dhe rritjen e taksës së fjetjes. Ndërsa për sa i përket rasteve me shtëpi, nga qeveria shqiptare është marrë masë me platformën Booking ku është bërë detyrim të regjistrohen me NIPT të gjithë ata që ishin të shënuar në Booking, përndryshe do përjashtoheshin nga platforma dhe kjo ka ndodhur. Dhe gjatë vitit do ju prezantojmë të dhëna për numrin

e NIPT-eve që janë shtuar tek strukturat e hotelerisë,
krahas këtyre, nga ana jonë me anë të strukturave të
terrenit do punohet për evidentimin e tyre dhe
kërkesës për bashkëpunim DPT pasi ajo është struktura
që merr masën e bllokimit të aktivitetit.
Por besoj që gjatë vitit do bëhet një punë paraprake
para se të fillojë sezoni, që të arrijmë të bëjmë
maksimumin.
- Ndue Luli: ka kush ndonjë diskutim?
Atëherë meqë nuk ka, falenderojmë drejtorin për
informacionin.
Atëherë kalojmë te pika 2 e rendit të ditës që
është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar
për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën
01-31 Dhjetor 2023".
Kush është dakord?
Miratohet me 23 vota PRO.
KUNDRA nuk ka. ABSTENIM nuk ka.
Kalojmë te pika 3 që është projekt vendim "Për
përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar
për ndihmën ekonomike (fondi 6%) për vitin 2024".
Një sqarim këtu. Dje, si rezultat i mungesës tonë si
këshilltarë, komisioni për çështjet sociale nuk funksionoi,
jo se munguan të gjithë, por nuk ishte kuorumi për
t'u bërë mbledhja, në emër të kryesisë kërkoj një
informacion të shkurtër në lidhje me këtë p/vendim
nga bashkia, drejtoresha apo ZV/kryetari.

- Marte Feta: Përshëndetje të gjithëve. Në fakt ne erdhëm dje për mbledhjen e komisionit por nuk ishin të pranishëm. Projekt vendimi ka të bëjë me kriteret që Sektori i ndihmës ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimit Social zgjedh familjet që do marrin 6%-shin. Kriteret janë të sqaruara aty. Gjëja kryesore është se çdo familje që do përfitojë 6% duhet të jetë aplikuese e sistemit të ndihmës ekonomike, por për shkak të pikëzimit nuk ne del fituese. Që të përfitojnë 6%-shin familjet duhet që të bëhet vlerësimi nga administratorët shoqërorë të të gjitha njësive administrative të Bashkisë Lezhë, një vlerësim social-ekonomik i cili i bashkëngjitet dosjes. Këto familje monitorohen çdo muaj nga administratori shoqëror për të parë nëse ka apo jo përmirësim.

- Ndue Luli: Faleminderit.

Fjalën e ka ZV/Kryetari.

- Agostin Marku: Pas sqarimit që bëri drejtoresha e Shërbimit dhe Kujdesit Social, na lind e drejta të bëjmë një ndryshim te titulli i vendimit. Mos të themi "për përdorimin e fondit" se del sikur ne po miratojmë një përdorim fondi por "kriteret ..."
Faleminderit.

- Ndue Luli: Ka kush ndonjë mendim tjetër? Atëherë meqë nuk ka, kush është dakord për miratimin e p/vendimit me ndryshimin që thamë?
Miratohet me 23 vota PRO.
KUNDRA nuk ka. ABSTENIM nuk ka.

Kalojmë te pika 4 që është projekt vendim "Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e qirasë për vitin 2024".
Nga bashkia kush mund të flasë në lidhje me p/vendimin?

- Nermina Shehi (specialiste Sh. Social) — Programi i subvencionimit të qirasë hartohet çdo vit nga bashkia. Lista bashkëngjitur p/vendimit është lista që do kalojë për subvencionim për vitin 2024 sipas të dhënave përkatëse që i ka tabela. Lista është miratuar paraprakisht me vendim të Komisionit të Strehimit.
- Ndue Luli: Faleminderit.
  Kush ka pyetje?
- Alfrida Marku: Në fakt unë kam jo vetëm pyetje por edhe diskutim për të sqaruar shumë paqartësi. Përveç një lapsusi që e diskutuam bashkë, që te vendimi duhet ndryshuar, ku flitet me shifra që i përkasin 12 muajve, ndërkohë aty tabela thotë 1 muaj, që besoj do ta korrigjoni.
  Subvencioni i qerasë është një ndër programet e strehimit social, që normalisht edhe detyrimisht do i nënshtrohet me përpikmëri të gjitha parashikimeve të ligjit 22/2018 "Për strehimin social".
  Neni 15, pika 3 e tij thotë "njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit për çdo vit". Mbi bazën e të cilit shqyrtohet dhe miratohet lista e përfituesve. Nuk më rezulton që për vitin 2024 të ketë të miratuar

me propozim nga bashkia sistem pikëzimi. Këtë e provoni edhe ju në relacionin bashkëngjitur p/vendimit ku jeni bazuar në VKB të vitit 2021. Pra, ju po hyni në vitin e tretë që nuk keni miratuar sistemin e pikëzimit mbi bazën e të cilit duhet të kryhet procedura me miratimin e listës së familjeve. Tjetër pikë po e nenit 15 është pika 5 ku thuhet "Lista e përfituesve dhe dokumentacioni përkatës vlerësohet nga komisioni i strehimit dhe miratohet nga këshilli. Ne si anëtarë të K.Bashkiak nuk kemi asnjë informacion tjetër mbi të cilin të votojmë PRO, KUNDËR apo ABSTENIM, përveç se p/vendimit, listës bashkëngjitur me 73 familje edhe një relacioni joshterues. mbi atë që unë kam mundësi të vlerësoj kam disa pyetje që i bëj mbi shumë ankesa që ka nga qytetarët sepse ekzistojnë familje që jetojnë në kushte të vështira që kanë aplikuar por nuk janë përfshirë në këtë listë. Sa ka qenë numri total i familjeve që kanë aplikuar në programin e strehimit për subvencionimin e qirasë, pranë Bashkisë Lezhë? Cilat janë shkaqet që për familjet e skualifikuara, ju jeni bazuar në mospërfshirjen në këtë listë? A janë respektuar kriteret e nenit 16 të ligjit 22/2018? Në këto raste a ka viktima të dhunës në familje apo viktima të trafikimit? A ka familje të policëve të rënë në detyrë? A ka individë me statusin e jetimit? A ka prindër që rrisin të vetëm fëmijët? A ka familje me

më shumë se 4 fëmijë apo me PAK në përbërje?
Për të përmbledhë, kërkoj që pasi që ju si bashki të paraqisni në këshill propozimin ku të propozoni sistemin e pikëzimit mbi bazën e të cilit të bëhet më pas përzgjedhja e familjeve që me të vërtetë duhet t'i ndihmojmë me subvencionimin e qerasë dhe së dyti, pasi të kemi ezauruar këtë fazë duhet që drejtoria t'i paraqesë Komisionit të Strehimit një relacion shterrues ku të përshkruhet gjendja për secilën familje. Që edhe ne si këshilltarë të kemi ndërgjegjen të pastër edhe të pastër.
Unë kërkoj që ky propozim të mos kalojë për votim pa sjellë bashkia sistemin e pikëzimit.

- Ndue Luli: Fjala për z. Agostin.
- Agostin Marku: Unë mendoj që së pari te ky propozim duhet rregulluar gabimi sepse duket sikur e kemi shifrën me lekë të vjetra.
- Nermina Shehi: Tabela është model që vjen nga ministria. Ndoshta te përshkrimi lart duhet ose të vendosim 12 muaj ose në vit.
- Agostin Marku: Po merremi me ca çështje teknike, prandaj thamë ne që duhet të mblidhen komisionet.
- Nermina Shehi: Ky është bashkëfinancim sepse 50% e paguajmë ne si bashki dhe 50% janë fond nga ministria.
- Agostin Marku: Duhet saktësuar atëherë. 50% i takon bashkisë dhe 50% buxhetit të shtetit.

Duhet cilësuar aty: jo subvencion mujor për mbulohet nga borxhi por subvencion vjetor për mbulohet nga borxhi. E dyta, mund të ndodhë për një familje të bëhet me të ardhura gjatë vitit. Atëherë ta shtojmë edhe një pikë në vendim ku të thuhet për skualifikohen gjatë vitit. Se ai me këtë vendim vazhdon e merr pagesën çdo muaj edhe së fundi, te koka e p/vendimit të shtohet fjala "mujore" pas fjalës "perosë" sepse pagesa i jepet çdo muaj familjes, pra nuk i jepet një herë në vit. Kalojmë te treta. Është shqetësim i drejtë ajo që ngriti Alfrida, që duhet sistemi i pikëzimit, por n.q.s. ne do e vonojmë edhe një muaj, edhe 2 muaj këtë, vetëm do sjellim një problem të ri social. Ne e kemi një vendim për sistemin e pikëzimit por kjo nuk do të thotë që ju të flini me atë vendim. Përgatitni të riun, ta sillni, n.q.s. me të riun ndonjë familje do dalë jashtë atij sistemi, pra në atë mbledhje që do miratojmë sistemin e pikëzimit, bëjmë edhe skualifikimin, në mënyrë që mos t'i lëmë këta njerëz të presin për çështjen e perosë.

Unë këto kisha

- Nermina Shehi: Për sqarim. Në lidhje me p/vendimin për sistemin e pikëzimit për programin e perave, në fakt ligji 22/2018 e parashikon që të bëhet çdo vit sistemi i pikëzimit, por

rradhën në, të familjeit që kanë qenë aplikuese dhe kanë plotësuar dokumentacionin sipas ligjit duke u bazuar në kriteret që u përmendën më përpara, nuk ka pasur ndryshime. Janë pothuajse të njëjtat kategori. Në lidhje me vlerat e pagave sipas strukturës së apartamentit ka familje po me numër të ndryshëm anëtarësh kanë pothuajse të njëjtën vlerë të subvencionimit të pagesë.

- Alfrida Marku: Se familje kanë aplikuar? Se janë skualifikuar?

- Nesmina Shehi: Mund të jenë edhe 10 familje që të jenë skualifikuar, por jo për arsye se i ka skualifikuar sistemi i pikëtimit, sepse janë pothuajse të njëjtat kategori që ne i kemi pa dhe aplikuese, por është për mungesë të plotësimit të dokumentacionit. deri në afatet ligjore që vendos ligji 22/2018.

- Alfrida Marku: Kategoria është kriter por nuk është përcaktuese.

Vetëm për transparencë. Unë tjetër po kërkoj zbatimin e ligjit që paraprakisht nga ana e D. Sh. Social të propozohet plotësimi për miratimin e sistemit të pikëtimit, në vijim të procedohet me miratimin e familjeve përfituese.

Kjo nuk e tejkat kohën, nuk penalizon asnjë përfitues sepse ne përveç mbledhjeve të radhës kemi dhe mbledhje për shkaqe të veçanta.

- Ndue Luli: Në lidhje me këtë p/vendim kishte këto fjalë unë: Do e hedhim në votim me këto ndryshime esenciale të cilat e bëjnë që të jetë vërtet brenda kornizave ligjore, dhe në lidhje me piketimin, drejtoria përkatëse, në mbledhjen e ardhshme, mund t'i paraqesë.
Me ndryshimet përkatëse që thamë, kush është dakord?
Miratohet me 22 vota PRO.
Këshilltarja Alfrida Marku nuk votoi.
Kalojmë te pika 5 - projekt vendim "Për miratimin e ndihmës financiare për z. L.M. nga fondi i emergjencës".
Meqënëse komisioni i Emergjencave Civile ka funksionuar, i fjalën e ka kryetari i komisionit.
- Pjetër Noka: Përshëndetje të gjithëve.
Uroj një vit të mbarë.
Ne u mblodhëm dhe sipas rastit e falenderoj çdo anëtar komisioni që asnjëherë nuk mungon. dhe ne e pamë të arsyeshme që të dyja familjeve, këtij rasti dhe atij të pikës 6, t'u akordohet ndihma financiare.
- Ndue Luli: Atëherë, në lidhje me p/vendimin në fjalë kush është dakord?
Miratohet me 23 vota PRO
0 kundër, 0 abstenim
I të njëjtës natyrë është dhe projekt vendimi.

në pikën 6 të rendit të ditës dhe konkretisht
"Për miratimin e ndihmës financiare për Znj. M. Gj.
nga fondi i emergjencës".
Kush është dakord?
Miratohet me 23 vota PRO.
0 kundër, 0 abstenim.
Kalojmë te pika 7 - projekt vendim "Për
një ndryshim në vendimin nr. 74, datë 14.12.2023
"Për miratimin e linjave të transportit të nxënësve
e mësuesve, pendrave të grumbullimit e biletave"".
Duhet të sqaroj se ndryshimet konsistojnë te
pika 1, ku hiqet fjala "të nxënësve". Gjithashtu
bëhet fjalë për heqjen e pikës 2 sepse tashmë
"shfuqizohet". Bëhet fjalë vetëm për mësuesit.
Është bërë ky ndryshim për të mirën e transportit
të mësuesve.
Kush është dakord me këtë ndryshim?
Miratohet me 22 vota PRO.
Këshilltarja Alfrida Marku nuk votoi.
Atëherë kalojmë te pika "Të ndryshme".
- Alfrida Marku: Në 22 janar i kam dërguar një shkresë
bashkisë ku, referuar buxhetit që është miratuar në dhjetor,
siç e dimë, janë parashikuar oficialisht 530 mln lekë për
rehabilitimin e rrugëve rurale dhe urbane, ndërkohë aty
nuk kishte asnjë detaj se cilat rrugë parashikon bashkia
që të ndërhyjë. Pyetja ime është: a ka Bashkia Lezhë
një dokument zyrtar të cilin ta paraqesë në këshill e

nëpërmjet këshillit ta bëjë publike. E dyta, gjithmonë
këtu referoj problemet që nuk i adresojnë qytetarët. Ka
shumë shqetësim, ku 12 familje të pallatit te ura,
i dëmtuar nga tërmeti, i shembur, që nuk ka akoma
asnjë hap drejt rindërtimit. Është aluduar për një
marrëveshje me një fondacion. Në emër të atyre banorëve
unë kam të drejtën të parashtroj një pyetje. Në çfarë faze
është rindërtimi i atij pallati por edhe i 40 banesave
individuale në njësitë e tjera administrative?
Në Torovicë ka familje në konteiner.

- Ndue Luli: Jemi në seancën e pyetjeve. Kush ka
diskutim, ju jap fjalën prapë.
Fjalën e ka z. Joku.

- Tonin Joku: Desha të pyes për fushën e stërvitjes
ose aneksi.

- Artan Ndreu: Në 2 mars duhet çfarë feste është.
Desha të pyes zv/kryetarin. A do e kemi bustin e Gjergj
Kastriotit? E dyta, në lidhje me certifikatën, a do
e anullojmë?

- Alfons Troshaj: I drejtohem kryesisë së këshillit Bashkiak.
A është e mundur të caktohet një datë dhe një orë
çdo muaj që këshilli të mblidhet fiks.
E dyta, të gjehet një mënyrë që komisionet të jenë
efikase, se përndryshe edhe këshilli nuk funksionon.
Po përsëri për të gjithë këshilltarët, të marrim një nismë,
të mbjellim të gjithë nga një pemë.
Tjetër, firma e pastrimit të zv/kryetar, është bërë

shumë problematike në Bashkinë Lezhë. Koshat janë të shpartalluar. Qytetarët nuk kanë ku t'i hedhin mbeturinat. T'i kemi çuar edhe me foto. Nuk e di a është marrë masë ndaj asaj firme.
E pesta, urat mbi lumin Mat janë bërë problematike, pavarësisht se nuk janë pjesë e Bashkisë Lezhë.

- Donika Hoxhia: Duke iu referuar vendimit të qeverisë për marrëveshjen Rama - Meloni, që kur u fol për të bashkia jonë nuk dinte asgjë. Në këtë moment që tashmë është bërë fakt, ju si bashki a mund të na jepni ndonjë informacion se çfarë është bërë dhe çfarë po bëhet?
- Ndrec Leli: Pyetje tjetër? Nuk ka.
  Atëherë Z. Zv/kryetar.
- Ermal Paçaj: Përshëndetje të gjithëve. Ndoshta nuk jam i partisë unë por kam idenë që për pikën "Të ndryshme", unë nuk jam gjithollog dhe të më drejtohen gjithë këto pyetje.. patjetër që unë e kam informacionin, por që informacioni të jetë sa më i saktë për ata që e kërkojnë, normalisht duhet të kem një listë të pikave të ndryshme që të vijmë me persona teknikë që t'ju japim përgjigje shteruese.

Megjithatë, Alfrida kërkoi informacion për rrugët. Ne në fakt kemi një program të rrugëve dhe nuk është 530 mln. Ne kemi ndarë diku te 180 mln lekë për rrugët rurale. Projekti ndahet në 3 faza, në projekt ide, projekt teknik dhe projekt zbatimi. Ne jemi në fazën e

projektit të zbatimit, aty ku doli dhe preventivimi. Ti më the që ke bërë një kërkesë dhe nuk ke marrë akoma përgjigje. Do e marrësh brenda ditës së nesërme. sepse ne i kemi rrugët dhe prioritetet.
E dyta, se i përket mesit të 40 shtëpive individuale, dhe mesit të pallatit, në fakt ne jemi drejt një marrëveshje me këta banorë për ndryshimin programi, nga programi që shteti t'u bëjë shtëpinë në që ata të ndërtojnë shtëpinë vetë. Ne sot i kemi lekët që kemë ardhur për ato shtëpi nga TUSH dhe do i kërkojmë Ministrisë së Infrastrukturës që të përkthehen në grant për të ndërtuar shtëpinë e vet. Se i përket pallatit te BKT, programi i rindërtimit ka detyrimin ligjor që ta rindërtojë. Unë e kam dhënë përgjigjen edhe herë tjetër se pse u shty deri sot një gjë e tillë. Në projektin fillestar të FSHZH, aty ishte për t'u ndërtuar edhe një pallat tjetër me 9 kate sipas turizmit por ne kemi insistuar që jo, që të ndërtohet një pallat i vogël aty ku ka qenë. Besoj se do e zgjidhim shumë shpejt në bazë të komunikimeve që kemi pasur me Ministrinë e Infrastrukturës. Nuk të jap dot datë, dhe deri në ditën që ata do marrin çelësat e shtëpisë, nuk kanë nevojë të jetojnë në kontenier. sepse marrin bonusin e qerasë.
Se i përket pyetjes së z. Jaku, nuk e kemi marrë akoma në dorë tim projektin "Duke të luajt". që ishte i FSHZH, sepse nuk ka përfunduar, sepse kontrata

aty është amenduar.
Sa i përket pyetjes së Artonit, Këshilli është organ epror i Bashkisë Lezhë, i ka të parta kompetencat ndërsa në lidhje me buxhetin, është diçka që të gjithë e duam por është diçka që ka kohën e vet edhe ajo. Nuk është se nuk është në axhendën e Kryetarit të Bashkisë. Nuk besoj se do jetë në këtë 2 mujor, por jam i bindur që deri te 2 mujori tjetër do ta kemi.
Në lidhje me pyetjen e z. Hoxha, sa i përket kampit të refugjatëve ne nuk jemi aktorë në këtë gjë, as pronarë. Po flasim për një objekt në pronësi të ushtrisë shqiptare që administrohet nga Ministria e Mbrojtjes. Nuk kemi lidhje fare me atë histori. Bashkia e Lezhës nuk e ka informacionin sepse nuk është aktor në këtë marrëveshje.
Sa i përket pyetjes së z. Troshaj, bëhet fjalë për zonën 2, kompania e pastrimit jep llogari në bashki. E kam ndjekur dhe do e ndjekim me përparësi.
- Ndue Luli: Është e drejtë ajo që tha z/kryetari. Kur janë pyetje që kanë lidhje me shifra, është mirë që të çohet me shkrim pranë kryesisë së këshillit, ose pranë sekretarisë së këshillit, në mënyrë që të njoftohet drejtoria përkatëse për atë problematikë që kërkon këshilltari. Ta kemi parasysh për herë të tjera. Në lidhje me mbledhjet e këshillit, ne

si kryesi këshilli kemi mendimin që së shpejti, të bëjmë disa ndryshime në rregulloren e këshillit, ku një nga pikat të jetë përcaktimi i datës fikse, duke vendosur të gjithë bashkë, i ditës fikse më saktë, për mbledhjen e radhës.
Në lidhje me mbledhjet e komisioneve, shumë nga ju keni marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve për të neglizhuar ato, do të thotë që mbledhja e këshillit të shkojë 2 orë, 3 orë. Pse? Sepse do merremi ne me ato gjërat teknike të cilat komisioni mund t'i diskutojë dhe kryetari i propozon këtu. U bëj thirrje të gjithë këshilltarëve që të jenë korrektë me mbledhjet e komisioneve.
Në lidhje me mbjelljen e pemëve – unë e përkrah një nismë të tillë, që propozon këshilltari.
Në lidhje me problemin e z. Ndreu, në mbledhjen e radhës të muajit dhjetor, këshilli ka marrë vendim për dhënien e çertifikatës së mirënjohjes. Ai nuk ka qenë prezent, por di që është marrë me shumicë votash dhe është konfirmuar nga Prefekti.
Ju falënderoj për pjesëmarrjen.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
Ndue Luli

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook, në faqen "Këshilli i Bashkisë Lezhë".